


Plani Zhvillimor Komunal i Mamushës

RAPORT VLERËSIMI

Tetor 2019



Financuar nga:



Implementuar nga:

UN HABITAT
FOR A BETTER URBAN FUTURE

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I MAMUSHËS
RAPORT VLERËSIMI

Tetor 2019

Komuna e Mamushës
Rr. "Saat Kule" - 20540 Mamushë
<https://kk.rks-gov.net/mamushe/>

Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanimet Njerëzore (UN-Habitat)
Ndërtesa e Ministrive "Rilindja", kati i 10-të, 10000 Prishtinë, Kosovë
www.unhabitat.org
www.unhabitat-kosovo.org

FALËNDERIME

Fotografitë, hartat dhe diagramet mund të riprodhohen nëse printohet edhe burimi.

FACILITATOR KRYESOR/ SHQYRTIMI I RAPORTIT:

Besnike Koçani
Sami Stagova

FACILITATOR/ AUTORE E RAPORTIT:

Alma Paçarizi

FACILITATOR:

Fati Pajko

MBËSHTETËS NGA MMPH:

Suzana Goranci
Arbën Rrecaj

LOGJISTIKË:

Adem Llabjani

PËRMBAJTJA

| | |
|---------------------|---|
| LISTA E SHKURTESAVE | 6 |
| LISTA E TABELAVE | 6 |
| LISTA E DIAGRAMEVE | 7 |
| LISTA E HARTAVE | 7 |

KAPITULLI I PARË

| | |
|---|----|
| Hyrje | 9 |
| Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Mamushës dhe UN-Habitat | 9 |
| Korniza Ligjore | 9 |
| Nga Plani për Zhvillim Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës | 10 |

KAPITULLI I DYTË

| | |
|---------------------------|----|
| Qëllimi i vlerësimit | 10 |
| Metodologjia e vlerësimit | 11 |

KAPITULLI I TRETË

| | |
|--|----|
| Përmbledhje e punëtorisë së vlerësimit | 13 |
| Sesioni i parë: Nga Plani Zhvillimor i Komunës tek Harta Zonale e Komunës | 14 |
| Sesioni i dytë: Mjetet e vlerësimit | 15 |
| Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë | 15 |
| Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK) | 21 |
| Vlerësimi i PZHK-së sipas zbatueshmërisë | 27 |

KAPITULLI I KATËRT

| | |
|-----------|----|
| Gjetjet | 29 |
| Hartëzimi | 32 |

KAPITULLI I PESTË

| | |
|--|----|
| Përfundime dhe Rekomandime | 38 |
| Udhërrëfyese për hartimin e Hartës Zonale të Komunës së Mamushës | 39 |

| | |
|---------|----|
| ANEKS A | 42 |
| ANEKS B | 56 |
| ANEKS C | 70 |
| ANEKS D | 77 |

LISTA E SHKURTESAVE

| | |
|------------|--|
| PZHK | Plani Zhvillimor Komunal |
| HZK | Harta Zonale e Komunës |
| MuSSP | Programi i Mbështetjes së Planifikimit Hapësinor Komunal |
| MMPH | Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor |
| IPH | Instituti për Planifikim Hapësinor |
| UN-Habitat | Programi i Kombeve të Bashkuara për Vendbanime Njerëzore |
| DZHPUGJK | Drejtoria për Zhvillim, Planifikim, Urbanizëm, Gjeodezi dhe Kadastër |
| DSHP | Drejtoria për Shërbime Publike |
| DBF | Drejtoria për Buxhet dhe Financa |
| DAKRS | Drejtoria për Arsim, Kulturë, Rini dhe Sport |
| DA | Drejtoria për Administratë |
| DSHMS | Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale |
| AKP | Agjencia Kosovare e Pronës |

LISTA E TABELAVE

| | |
|------------|--|
| Tabela 1. | Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për Kornizën për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë |
| Tabela 2. | Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për të dhënat komunale |
| Tabela 3. | Paraqitja skematike e përmbajtjeve të tabelës për metodën e zbatimit |
| Tabela 4. | Rezultatet nga grafikët për planifikimin urban dhe të tokës |
| Tabela 5. | Rezultatet nga grafikët për hapësirat publike |
| Tabela 6. | Rezultatet nga grafikët për parcela dhe blloqe |
| Tabela 7. | Rezultatet nga grafikët për të drejtat zhvillimore |
| Tabela 8. | Rezultatet nga grafikët për kodin e ndërtimit |
| Tabela 9. | Rezultatet nga grafikët për financat e bazuara në tokë |
| Tabela 10. | Objektivat për secilën fushë tematike dhe numri i aktiviteteve |
| Tabela 11. | Shkalla e zbatimit për të gjitha fushat tematike |


LISTA E DIAGRAMEVE

| | |
|--------------|--|
| Diagrami 1. | Vlerësimi për planifikimin urban dhe të tokës |
| Diagrami 2. | Vlerësimi për hapësirat publike |
| Diagrami 3. | Vlerësimi për parcelat dhe blloqet |
| Diagrami 4. | Vlerësimi për të drejtat zhvillimore |
| Diagrami 5. | Vlerësimi për kodin e ndërtimit |
| Diagrami 6. | Vlerësimi për financimin e bazuar në tokë |
| Diagrami 7. | Disponueshmëria e të dhënave për strukturën dhe infrastrukturën ekonomike (sipërfaqet) të PZHK-së |
| Diagrami 8. | Disponueshmëria e të dhënave për vendbanimet dhe infrastrukturën e banimit |
| Diagrami 9. | Disponueshmëria e të dhënave për demografinë, infrastrukturën ekonomike (mdërmarrjet) dhe buxhetin |
| Diagrami 10. | Disponueshmëria e të dhënave për shërbimet dhe infrastrukturën sociale dhe publike |
| Diagrami 11. | Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën teknike |
| Diagrami 12. | Të dhënat e infrastrukturës së transportit publik |
| Diagrami 13. | Disponueshmëria e të dhënave për trashëgiminë kulturore/natyrore dhe mjedisin |
| Diagrami 14. | Zbatimi i objektivave të zhvillimit shoqëror |
| Diagrami 15. | Zbatimi i objektivave të zhvillimit ekonomik |
| Diagrami 16. | Zbatimi i objektivave të infrastrukturës së transportit publik |
| Diagrami 17. | Zbatimi i objektivave të infrastrukturës teknike |
| Diagrami 18. | Zbatimi i objektivave të shfrytëzimit të tokës, vendbanimeve dhe banimit |
| Diagrami 19. | Zbatimi i objektivave të trashëgimisë kulturore/natyrore dhe mjedisit |
| Diagrami 20. | Rezultatet e krahasimit për të gjitha fushat tematike - Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë |
| Diagrami 21. | Krahasimi i disponueshmërisë së të dhënave të PZHK-së për të gjitha fushat tematike |
| Diagrami 22. | Shkalla krahasuese e zbatimit për të gjitha fushat tematike |

LISTA E HARTAVE

| | |
|----------|--|
| Harta 1. | Konteksti rajonal dhe kombëtar i Mamushës |
| Harta 2. | Lokacionet e aktiviteteve/shërbimeve të zbatuara në fushën e Zhvillimit Social dhe Zhvillimit Ekonomik |
| Harta 3. | Lokacionet e aktiviteteve/shërbimeve të zbatuara në fushën e Infrastrukturës së Transportit Publik dhe Infrastrukturës Teknike |
| Harta 4. | Lokacionet e aktiviteteve/shërbimeve të zbatuara në fushën e Shfrytëzimit të tokës, Vendbanimeve dhe Banimit, si dhe Trashëgimisë Kulturore/Natyrore dhe Mjedisit. |

Harta 1. Konteksti rajonal dhe kombëtar i Mamushës



KAPITULLI I PARË

1.1 Hyrje

Komuna e Mamushës gjendet në rajonin jugor të Kosovës. Përfshinë një zonë prej 10.94 km² (që është vendbanimi i vetëm komunal) dhe është njësi më e vogël nga të gjitha njësitë komunale në Kosovë. Kufizohet me Komunën e Prizrenit (në juglindje), Komunën e Suharekës (në verilindje) dhe Komunën e Rahovecit (në veriperëndim). Mamuša ka qenë një fshat që i përkiste Komunës së Prizrenit dhe ka funksionuar si komunitet rural deri në vitin 2005 kur ka filluar procesi i decentralizimit. Në këtë proces Mamuša ka marrë statusin e komunë pilote (së bashku me Parteshin, Hanin e Elezit, Junikun dhe Graçanicën), ndërsa kompetencat e plota komunale i ka marrë në vitin 2009. Nga viti 2011, popullsia e Mamushës është vlerësuar të jetë 5,507 banorë, me dendësi prej 503.4 banorë/km²; ku Turqit (93%), Shqiptarët (6%) dhe Romët, Ashkalinjtë apo Egjiptianët (RAE, 1%) janë etnitetet kryesore në këtë zonë.

Mamuša është komunë rurale, me tokë bujqësore të cilësisë së mirë dhe shumë të përshtatshme për kultivimin e perimeve dhe kulturave (kryesisht kultivimin e domateve). Serrat shtrihen në 170 hektarë tokë, duke mbuluar pjesën më të madhe të komunës që i dedikohet prodhimit bujqësor apo industrive që kanë të bëjnë me bujqësinë. Këto toka janë kryesisht në pronësi të banorëve lokalë (78% e ekonomive familjare) dhe gjenerojnë më së shumti të ardhura; si rezultat, vetëpunësimi apo puna me bazë familjare janë shumë të zakonshme në Mamushë. Megjithatë, sektorët tjerë që ofrojnë punësim përfshijnë sektorin publik dhe bizneset e vogla.

1.2 Bashkëpunimi ndërmjet Komunës së Mamushës dhe UN-Habitat

UN-Habitat ka ndihmuar në mënyrë aktive institucionet e Kosovës në fushën e qeverisjes, planifikimit hapësinor dhe administrimit komunal që nga viti 1999. Programi për Mbështetje të Planifikimit Hapësinor Komunal (MuSPP është zbatuar nga viti 2005 deri në vitin 2016) ka ofruar planifikim hapësinor dhe mbështetje tjetër të ndërlidhur të 12 komuna partnere nga të cilat Komuna e Mamushës është mbështetur kryesisht në procesin e hartimit të Planit Zhvillimor Komunal (2014-2023). Duke u bazuar në rezultatet dhe udhëzuesit e gjeneruar nga Programi MuSPP, Zyra e UN-Habitatit në Kosovë vazhdon të jetë në pozitë që të ofrojë pako strategjike dhe gjithëpërfshirëse të mbështetjes për ngritjen apo plotësimin e kapaciteteve për planifikimin dhe menaxhimin komunal dhe funksionet tjera sipas nevojës dhe resurseve (të vëna) në dispozicion.

Me reformën e re ligjore mbi planifikimin hapësinor dalin kërkesa të reja ligjore, si Harta Zonale e Komunës (HZK). Si e tillë, Komuna e Mamushës filloi procesin duke e shprehur interesin për të punuar me UN-Habitat në hartimin e Hartës Zonale të Komunës. Si rezultat, UN-Habitat është duke facilituar procesin e hartimit të HZK të Mamushës duke vlerësuar gjendjen aktuale të zhvillimit në komunë në aspektin se si ky zhvillim është në përputhje me kornizën e planifikuar zhvillimore të Planit Zhvillimor Komunal të hartuar në vitin 2014 dhe bazës së tij ekzistuese të të dhënave të planifikimit hapësinor. Grafiku organizativ i propozuar i burimeve njerëzore që kërkohet për ciklin e ri të planifikimit hapësinor dhe formalizimin e strukturave të nevojshme brenda grafikut gjithashtu do të jetë pjesë e mbështetjes. Të gjitha aktivitetet do të koordinohen nga afër me Drejtorinë për Urbanizëm, si autoritet zyrtar për planifikim hapësinor. Ky hap fillestar do të rezultojë me nxjerrjen e Raportit të Vlerësimit të PZHK-së, si dhe Udhërrëfyesit për hartimin e Hartës Zonale të Komunës dhe fuqizimin e bazës së të dhënave hapësinore.

1.3 Korniza ligjore

Vlerësimi i PZHK-së të Mamushës bazohet në disa kërkesa ligjore që mbështesin proceset relevante të planifikimit hapësinor dhe janë aprovuar nga Qeveria e Kosovës apo Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). Për të filluar, korniza e planifikimit hapësinor në Kosovë përcaktohet me Ligjin nr. 0/L-17 për Planifikimin Hapësinor, të miratuar në vitin 2013.

Sipas nenit 5, paragrafi 1 (1.2) i këtij ligji, autoritetet e planifikimit të nivelit lokal duhet të hartojnë PZHK-në (një të tillë tashmë Mamuša e ka miratuar) dhe pastaj të vazhdojnë me hapin e radhës, që është HZK.

PZHK i Mamushës është hartuar në vitin 2014 sipas Ligjit paraparak nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor dhe Ligjit nr. 2003/L-106 për ndryshimin e Ligjit nr. 2003/14 për Planifikimin Hapësinor, tashmë i shfuqizuar. Dokumente tjera të rëndësishme që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit janë: (1) Udhëzimi Administrativ nr. 24/2015 për Elementet dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planeve Rregulluese të Hollësishme, dhe (2) UA nr. 11/2015 për Pjesët dhe Kërkesat Themelore për Hartimin, Zbatimin dhe Monitorimin e Planit Zhvillimor Komunal.¹

1.4 Nga Plani për Zhvillim Komunal drejt Hartës Zonale të Komunës

Plani Zhvillimor i Komunës (PZHK) së Mamushës është dokument multisektorial që përcakton qëllimet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor. Përfshinë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për një periudhë prej së paku 8 vite.² Është hartuar në vitin 2014 dhe është i vlefshëm deri në vitin 2023. Në ligjin e ri prezantohet Harta Zonale e Komunës (HZK) – dokument multi-sektorial që përmes grafikoneve, hartave dhe tekstit përcakton hollësisht llojin, destinimin, shfrytëzimin e planifikuar të hapësirës dhe masat e veprimit të cilat bazohen në kohëzgjatje dhe projeksione të arritshme të investimeve publike dhe private për tërë territorin e Kosovës, për një periudhë së paku tetë (8) vjeçare – si faza e radhës e zhvillimit hapësinor.³

2.1 Qëllimi i vlerësimit

Vlerësimi ka për qëllim mbështetjen e Komunës së Mamushës në vlerësimin e vlefshmërisë së Planit Zhvillimor Komunal (PZHK-së) në lidhje me hartimin e Hartës Zonale të Komunës (HZK-së); gjithashtu informon stafin komunal për mjetet e vlerësimit të PZHK-së që përdoren për realizimin e këtij procesi. Për këtë qëllim, të gjithë akterët relevantë (Komuna e Mamushës, kompanitë publike rajonale, shoqëria civile, MMPH dhe UN-Habitat) mblidhen së bashku për të vlerësuar qëndrueshmërinë e procesit të planifikimit nëpërmjet disa fushave ndërdisiplinore, për të identifikuar të dhënat që mungojnë e që janë të nevojshme për hartimin e HZK-së dhe për të vlerësuar objektivat e PZHK-së në bazë të projekteve/shërbimeve të zbatuara deri më tani nga data e aprovimit. Tri metodologjitë kryesore të vlerësimit të PZHK-së së Mamushës janë:

- I. Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë
- II. Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhëna të nevojshme për HZK)
- III. Vlerësimi i PZHK-së në bazë të zbatimit

Në fund të procesit të vlerësimit do të prezantohen hapat e radhës lidhur me fazën e ardhshme të zhvillimit (HZK).

2.2 Metodologjia e vlerësimit

2.2.1 Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Metoda e parë e vlerësimit është Korniza për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë (fillimisht si Korniza për Vlerësimin e Ligjit të Planifikimit⁴) e zhvilluar nga Njësia për Legjilacion urban e UN-Habitat-it. Është mjet i shpejtë i vetëvlerësimit që përdoret për identifikimin e përparësive dhe dobësive të proceseve të planifikimit hapësinor në bazë të ligjeve dhe rregulloreve relevante që vlejné në një qytet. Mjeti bazohet në dy tregues kryesorë, gjegjësisht në (1) efikasitetin legjislativ funksional dhe (2) aspektet teknike për secilën fushë, i nxitur nga nëntreguesit me pesë skenarë të ndryshëm, nga më i keqi (0) deri të më i miri (4). Rezultatet e përgjithshme të bashkuara japin një vlerësim të qëndrueshëm, të përgjithshëm dhe krahasues nëpërmjet grafikoneve, duke dhënë në këtë mënyrë rezultate të vlefshme lidhur me: qëndrueshmërinë sociale/gjithëpërfshirjen dhe kohezionin; qëndrueshmërinë/rritjen ekonomike; qëndrueshmërinë/mbrojtjen dhe zhvillimin mjedisor; dhe qeverisjen/zhvillimin gjithëpërfshirës dhe të mirë. Fushat kryesore tematike janë:

1. Planifikimi urban dhe i tokës
2. Hapësira publike
3. Parcela dhe blloqe
4. Të drejtat zhvillimore
5. Kodet e ndërtimit
6. Financat e bazuara në tokë

Skema e mëposhtme është ilustrim i të dhënave të kërkuara (në radhitje tabelore) për vlerësimin e qëndrueshmërisë, në bazë të tabelave përkatëse të mjetit të vlerësimit.⁵

| FUSHA TEMATIKE | | | |
|-------------------------------|-----------------|------------------|-------|
| Indikatorët | Nën-indikatorët | Rankimi 0 deri 4 | Pikët |
| Efikasiteti ligjor funksional | 1 deri 5 | | |
| Aspektet teknike | 1 deri 5 | | |

Tabela 1. Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për Kornizën për Vlerësimin e Qëndrueshmërisë

2.2.2 Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)

Metoda e dytë e vlerësimit përdoret për vlerësimin e përputhshmërisë së PZHK-së me kornizën ligjore për planifikimin hapësinor, përfshirë të dhënat e PZHK-së, në bazë të të cilave është bërë analiza dhe planifikimi i nevojshëm. Për të aplikuar këtë metodë, është shqyrtuar korniza ligjore për planifikim hapësinor, nga e cila është përpiluar një listë e të gjitha të dhënave të nevojshme për hartimin e HZK. Lista ka qenë referenca kryesore në bazë të së cilës janë zhvilluar këto mjete të vlerësimit. Rezultatet kryesore të kësaj metodologjie janë fituar nëpërmjet vëzhgimit nga afër të:

- Strukturës/përmbajtjes së PZHK-së (pjesa tekstuale dhe kartografike) – për t'i përmbushur kërkesat ligjore
 - Të dhënat (tabelat) komunale – për të analizuar gjendjen aktuale në komunë
- Vlerësimi i të dhënave, sipas përmbajtjes së tabelës, është bërë në dy sesione: (1) Vlerësimi i të dhënave të profilit të PZHK-së, dhe (2) Vlerësimi i zhvillimit të planifikuar të PZHK-së. Fushat tematike në këtë metodë janë:

1. Struktura e PZHK+Infrastruktura Teknike/sipërfaqet
2. Vendbanimet+ Infrastruktura e banimit
3. Demografia + Infrastruktura Ekonomike/Ndërmarrja+Buxheti
4. Infrastruktura dhe Shërbimet Sociale/Publike
5. Infrastruktura dhe Shërbimet Teknike
6. Infrastruktura e Transportit Publik
7. Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore + Mjedisi

Skema është ilustrim i të dhënave komunale të kërkuara të PZHK-së (në radhitje tabelore) për këtë metodologji në bazë të tabelave përkatëse të mjetit të vlerësimit.⁶

| FUSHA TEMATIKE | | |
|-----------------------|---------------------------------|---|
| | PROFILI | KONCEPTI ZHVILLIMOR |
| | Lloji i të dhënave | Lloji i të dhënave |
| SEKTORËT SIPAS FUSHËS | Të dhënat e profilit të PZHK-së | Të dhënat e konceptit zhvillimor të PZHK-së |

Tabela 2. Paraqitja skematike e përmbajtjes së tabelës për të dhënat komunale

¹ PZHK për Mamushën (2014-2023) është hartuar sipas ligjit të vjetër, por vlerësimi do të bazohet në ligjin e ri. Referenca tjera: UA nr. 08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor
² Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor
³ Ligji nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor

⁴ Korniza për Vlerësimin e Ligjit për Planifikim (UN-Habitat)
⁵ Mjetet e vlerësimit të detajuara janë bashkëngjitur në Aneks A
⁶ Mjetet e vlerësimit të detajuara janë bashkëngjitur në Aneks B

2.2.3 Vlerësimi i PZHK-së sipas zbatueshmërisë

Metoda e vlerësimit të tretë dhe final përdoret për identifikimin dhe vlerësimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të zbatuara për çdo fushë tematike dhe objektiv të PZHK-së. Këta objektiva, në përputhje me të dhënat e PZHK-së, janë zbatuar nëpërmjet iniciativave zhvillimore private dhe publike; prandaj, me këtë metodologji provohet të vlerësohet niveli i zbatimit të tyre që është bërë deri më tani që nga data e aprovimit. Fushat tematike në kuadër të kësaj metodologjie janë identifikuar nga PZHK-ja e Mamushës dhe janë përcaktuar në mënyrë të atillë që të mundësojnë vlerësimin më të mirë të gjendjes aktuale në komunë.

Secila tabelë e mjeteve në këtë metodologji mbulon një fushë tematike ndërdisiplinare në detaje, duke dhënë informacione shtesë për objektivat, aktivitetet, partnerët financues, fazën e zbatimit, prioritetet, koston dhe treguesit (të dhënat e mbledhura paraprakisht). Fushat tematike të mbuluara në këtë metodë janë:

1. Zhvillimi social
2. Zhvillimi ekonomik
3. Infrastruktura e transportit publik
4. Infrastruktura teknike
5. Shfrytëzimi i tokës, vendbanimet dhe banimi
6. Mjedisi, trashëgimia, vlerësimi i rrezikut dhe menaxhimi i fatkeqësive

Skema e mëposhtme ilustron aktivitetet/shërbimet e kërkuara (në radhitje tabelore) për këtë metodologji, në bazë të tabelave përkatëse të mjeteve të vlerësimit.⁷⁸

| FUSHA TEMATIKE | PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL | | | | | | | | | | | | | | | |
|----------------------------------|--------------------------|--------|--------|-------------|--------|--------|-------------|--------|--------|-------------|--------|--------|--------------------|--------|--|--|
| | QËLLIMI 1 | | | | | | QËLLIMI 2 | | | | | | Të tjera (nëse ka) | | | |
| | Objektiva 1 | | | Objektiva 2 | | | Objektiva 3 | | | Objektiva 4 | | | | | | |
| | Akt. 1 | Akt. 2 | Akt. 3 | Akt. 1 | Akt. 2 | Akt. 3 | Akt. 1 | Akt. 2 | Akt. 3 | Akt. 4 | Akt. 1 | Akt. 2 | Akt. 3 | Akt. 4 | | |
| | KOMPONENTËT TJERË | | | | | | | | | | | | | | | |
| AKTIVITETET/SHËRBIMET E ZBATUARA | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti 1 | Komponentët tjerë | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti 2 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Aktiviteti 3 | | | | | | | | | | | | | | | | |
| Të tjera | | | | | | | | | | | | | | | | |

Tabela 3. Paraqitja skematike e përmbajtjeve të tabelës për metodën e zbatimit

KAPITULLI I TRETË

3.1 Përmbledhje e punëtorisë së vlerësimit

Në javën e dytë të korrikut (8-11/07/2019), Komuna e Mamushës, mbështetur nga zyra e UN-Habitat-it në Kosovë, ka mbajtur një punëtori 3-ditore në Manastir, Maqedoni e Veriut.

Qëllimi kryesor i këtij eventi ishte Vlerësimi i Planit Zhvillimor Komunal (PZHK) të Mamushës (2014-2023), ku tregohet vlefshmëria ligjore dhe konceptuale e dokumentit të PZHK-së për të realizuar fazën e ardhshme të hartimit të Hartës Zonale të Komunës (HZK). 30 zyrtarë (Kryetari i Mamushës, staf komunal nga departamente të ndryshme, përfaqësues të kompanive publike regjionale dhe organizatave të shoqërisë civile) morën pjesë në arritjen e objektivave të kësaj punëtorie, duke përfshirë gjithashtu përfaqësues nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)/Instituti për Planifikim Hapësinor (IPH).

Përfaqësuesit e UN-Habitatit në Kosovë kanë dhënë fjalimet hyrëse, duke iu shprehur pjesëmarrësve mirëseardhje dhe duke shpjeguar qëllimin e eventit. Pastaj fjala i është dhënë Kryetarit të Mamushës, i cili diskutoi shkurtimisht rëndësinë dhe ndikimin e procesit në baza komunale. Në këtë mënyrë, Udhëheqësi i Divizionit për Planifikim Hapësinor në kuadër të MMPH përgëzoi për iniciativën dhe argumentoi që vlerësimi i PZHK-së është një hap i madh përpara. Më tej u dakorduan që raporti i vlerësimit duhet të hartohet si produkt final i këtij procesi dhe u diskutuan bashkërisht hapat e radhës lidhur me Hartën Zonale të Komunës.

3.2 Sesioni i parë: Nga Plani Zhvillimor i Komunës tek Harta Zonale e Komunës

Për të filluar ngjarjen, një numër prezantimesh u dhanë nga përfaqësuesit e UN-Habitat dhe MMPH-së për të informuar grupin rreth procesit. Së pari, Udhëheqësi i Divizionit të Planifikimit Hapësinor nga MMPH-ja prezantoi kornizën ligjore të PZHK-së dhe HZK-së dhe shpjegoi hapat kryesorë të procesit të planifikimit siç janë hartimi, shqyrtimi publik, miratimi, etj. Më pas, përfaqësuesit nga UN-Habitat Kosova shkëmbyen përvojat e mëparshme të programeve në procesin e planifikimit. Seanca përfundoi me një prezantim në lidhje me metodat e vlerësimit: (1) Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë, (2) Vlerësimi i bazuar në kërkesat ligjore, dhe (3) Vlerësimi i sipas zbatueshmërisë.



3.3 Sesionit i dytë: Mjetet e vlerësimit

3.3.1 Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Pjesëmarrësit u ndanë në 7 grupe për t'a realizuar detyrën nëpërmjet diskutimeve në grup dhe të gjitha prezantimeve interaktive të rezultateve, përfshirë grafikët si rezultate përfundimtare të ilustruara në fund të sesionit. Detyra u nda në dy sesione. Së pari, grupet duhet të hartonin një përkufizim për secilën fushë tematike përkatëse dhe më pas pikat e forta dhe dobësitë, dhe rrjedhimisht u identifikuan aktivitetet e nevojshme (sipas kërkesave të komunave). Së fundmi, secili grup duhej t'i vlerësonte treguesit¹⁰ për secilën fushë tematike në një skenar nga më i dobëti (0) deri te më i miri (4), gjë që shfaq nivelin e arritjes së qëndrueshme. Gjetjet u prezantuan në fund të sesionit me grafikë që po ashtu shfaqin krahasime ndërmjet secilës fushë tematike. Rezultatet e prezantuara në këtë sesion janë gjetjet për secilin grup në radhitjen e tyre përkatëse.

Planifikimi Urban dhe i Tokës

Definicioni:

Planifikimi urban dhe i tokës është ndarja e zonave urbane sipas shfrytëzimit të planifikuar të tokës.

Përparësitë:

Disponueshmëria e PZHK-së
Zbatimi i shumicës së veprimeve të planifikuara në PZHK
Cilësia e planit (nga pjesëmarrja e komunitetit) në përgatitje

Dobësitë:

Ndërtimi i paligjshëm
Zvogëlimi i ndërtimeve në zonat bujqësore
Mungesa e ndërgjegjshmërisë për lejet ndërtimore

Aktivitetet:


Inspektorët efikas
Fushatat e ndërgjegjësimit

Diskutimi kryesor:

Shkalla e zbatimit të PZHK-së

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|-------------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Planifikimi Urban dhe i Tokës | Efikasiteti funksional | 14 |
| | Aspektet teknike | 16 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 30 |

Tabela 4. Rezultatet nga grafikët për planifikimin urban dhe të tokës



Diagrami 1. Vlerësimi i planifikimit urban dhe të tokës

Hapësira Publike

Përkufizimi:

Hapësirat publike përcaktohen si zona që mund të përdoren në mënyrë të barabartë nga të gjithë banorët.

Përparësitë:

Të gjitha hapësirat publike mirëmbahen nga komuna (p.sh. parqet, këndet e lojërave, zonat rekreative, etj.). Kjo ofron një menaxhim më të mirë të hapësirave publike.

Dobësitë:


Fusha ekzistuese e sporteve nuk është funksionale sepse nuk ka një infrastrukturë të përshtatshme
Shumë zona nuk janë funksionale
Nuk ka asnjë zyrtar komunal për çështje të tilla

Aktivitetet:

Shndërrimi i hapësirave publike në zona funksionale, përmirësimi i kushteve dhe infrastrukturës së tyre
Mirëmbajtja dhe rigjallërimi i hapësirave ekzistuese jofunksionale (lumi, ura, etj.)
Aktivizimi i inspektoratit (fuqizimi i ligjit)

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|--------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Hapësira Publike | Efikasiteti funksional | 10 |
| | Aspektet teknike | 5 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 15 |

Tabela 5. Rezultatet nga grafikët për hapësirat publike



Diagrami 2. Vlerësimi për hapësirat publike

Parcelat dhe Bllloqet

Përkufizimi:

Parcelat janë një copë toke me kufij të caktuar. Në parcelë kryhen aktivitete të ndryshme, të tilla si: ndërtim, bujqësi, vend i punës, etj.
Bllloqet janë zona që përbëhen nga disa parcela me kufij të kufizuar. Këta kufij përfshijnë lumin, rrugët, etj.

Përparësitë:

Parcelat regjistrohen në mënyrë digjitale.
Ka personel të mjaftueshëm.
Kufijtë e parcelës dhe/ose tokës rregullohen në përputhje me rrethanat.
Mamuša është një zonë e vogël, kështu që bllloqet nuk përcaktohen domosdoshmërisht.
Shërbimet ofrohen shpejt

Dobësitë:


Shumica e qytetarëve të Mamushës nuk janë pronarë të regjistruar të tokave.
Ekzistojnë shumë ndërlikime në blerjen dhe shitjen e parcelave.
Në disa raste, ekziston një problem transporti në parcelat bujqësore.

Diskutimet kryesore:

Efikasiteti i shërbimit
Numri i parcelave duhet të përmendet në përkufizimin e fushës (sugjeruar nga MMPH)

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|--------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Parcelat dhe Bloqet | Efikasiteti funksional | 14 |
| | Aspektet teknike | 9 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 23 |

Tabela 6. Rezultatet nga grafikët për parcela dhe blloqe



Diagrami 3. Vlerësimi për parcela dhe blloqe

Të Drejtat Zhvillimore

Përkufizimi:

Ndërtimi i kopshtit në ngastër sipas projektit.
Marrëveshja e qiradhënies së tokës

Përparësitë:

Të ardhurat - Taksat - Komuna + Qeveria
Mundësi pune

Dobësitë:


Mungesa e personelit në sektorët e inxhinierisë civile, arkitekturës, inspektoratit, ligjit dhe qeverisjes.

Diskutimet kryesore:

Zbatimi i mungesave të personelit, ligjeve dhe rregulloreve të mësipërme në të drejtat zhvillimore.

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|--------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Të drejtat zhvillimore | Efikasiteti funksional | 5.00 |
| | Aspektet teknike | 1.67 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 6.67 |

Tabela 7. Rezultatet nga grafikët për të drejtat zhvillimore



Diagrami 4. Vlerësimi për të drejtat zhvillimore

Kodi i Ndërtimit

Përkufizimi:

Kodi i ndërtimit është një koleksion i rregullave, normave dhe legjislacionit që mbulon fushën e ndërtimit që siguron kushtet dhe parimet e barazisë dhe ligjshmërisë, ndërtime me kosto të ulët dhe me efikasitet të energjisë, ndërtime të forta dhe të qëndrueshme, planifikim të rrezikut të ulët, etj.

Përparësitë:

Udhëzime/rregullore të qarta
Kriteret e fizibilitetit
Kostoja me mbulim
Ndërtimi në harmoni me natyrën
Reduktimi i rrezikut, etj.

Dobësitë:

Nuk ka asnjë kod të ndërtimit
Udhëzime/rregullore/udhëzime administrative të paqarta
Veprimet e dyfishta
Mungesa e interesit për veprime juridike

Aktivitetet:


Hartimi i kodit të ndërtimit
Kritere të qarta
Koordinimi i legjislacionit me kodet e ndërtimit
Parimet - Veprimet ligjore dhe afatet e barabarta
Transparenca dhe informacioni

Diskutimet kryesore:

Legalizimet dhe procesi i gjatë që kërkon (HZK do të ndihmonte në shkurtrimin e procesit të legalizimit)

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|--------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Kodi i Ndërtimit | Efikasiteti funksional | 2 |
| | Aspektet teknike | 4 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 6 |

Tabela 8. Rezultatet nga grafikët për kodin e ndërtimit



Diagrami 5. Vlerësimi për kodin e ndërtimit

Financat e bazuara në tokë

Përkufizimi:

Kuptimi dhe vlerësimi i vlerës së një toke në mënyrë që komuna të gjejë mënyra për të gjeneruar më shumë të ardhura.

Përparësitë:

Njerëzit që jetojnë në Mamushë janë shumë produktivë dhe nuk është e nevojshme që këto toka të merren me qira sepse vetë njerëzit operojnë dhe gjenerojnë të ardhura.

Njerëzit që zotërojnë ose zhvillojnë tokën mund t'ia lëshojnë atë me qira një firme të huaj dhe të sigurojnë që komuna merr taksë.

Për të prodhuar produkte bujqësore të kultivuara në këto toka, objektet e përpunimit mund të krijohen në toka publike dhe private.

Dobësitë:

Komuna e Mamushës zotëron një sipërfaqe të vogël të tokës publike.

Privatizimi i tokës komunale. Nëse do të kishte një plan zhvillimor, komuna do të mund t'i blinte këto toka.

Diskutimet kryesore:

Përdorimi dhe funksionaliteti i tokës komunale (Kush i zotëron/i përdor ato dhe kush lëshon lejen për përdorimin e tyre? Për çka përdoret toka/parceta? A ka ndonjë aktivitet të planifikuar?)

Përfshirja e AKP-së, privatizimi i tokës dhe menaxhimi i pronave shoqërore

Zgjidhje të mundshme në rast të interesit komunal për shkëmbimin e pronave ose kthimin e tokës së tyre (koordinimi ndërmjet departamenteve përkatëse komunale)


Dokumenti i Planifikimit Hapësinor ndihmon në përcaktimin e sektorëve përkatës ku mund të bazohen dokumentet komunale

| Fusha e planifikimit | Indikatorët | Nën-indikatorët (Pikët nga 20) |
|----------------------------|------------------------|--------------------------------|
| Financat e bazuara në tokë | Efikasiteti funksional | 11.00 |
| | Aspektet teknike | 12.50 |
| Totali i pikëve (nga 40) | | 23.50 |


Tabela 9. Rezultatet nga grafikët për financat e bazuara në tokë

Vlerësimi sipas Indikatorëve

● Efikasiteti funksional ● Aspektet teknike



Vlerësimi gjeneral



Diagrami 6. Vlerësimi për financat e bazuara në tokë

3.3.2 Vlerësimi i PZHK-së në bazë të kërkesave ligjore (të dhënat e nevojshme për HZK)


Të ndarë në 7 grupe, pjesëmarrësit vazhduan me mjetet e tjera të vlerësimit, që do të thotë se ata duhet të plotësonin tabelat bazuar në dokumentin e PZHK-së. Disponueshmëria e të dhënave në PZHK u tregua në tre mënyra: në dispozicion (e gjelbërt), pjesërisht e disponueshme (e verdhë) dhe jo e disponueshme (vjollcë) (Shih Shtojcën B). Vlerësimi, sipas përmbajtjes së tabelës, është realizuar në dy sesione: (1) vlerësimi i të dhënave të profilit të PZHK-së, dhe (2) vlerësimi i zhvillimit të planifikuar të PZHK-së. Rezultatet u prezantuan në fund të sesionit nga secili grup ndërsa diskutuan edhe për përmbajtjen e tabelës.¹¹

Struktura e PZHK-së + Infrastruktura Ekonomike (Sipërfaqet)

Fusha e parë tematike ka të bëjë me strukturën dhe përmbajtjen e dokumentit të PZHK-së, dhe Infrastruktura Ekonomike bazuar në sipërfaqe. Ka dy tabela që duhet të jenë të plotësuara, një për secilën temë. E para është tabela për strukturën e PZHK-së dhe ka të bëjë me pjesën tekstuale dhe hartografike të dokumentit. Qëllimi është të rishikohet përmbajtja e PZHK-së përfshirë hartat përkatëse nëse ato janë të përshtatshme dhe të bazuara mirë në legjislacionin në fuqi, gjithmonë duke mbajtur në mend hapin tjetër që është HZK.

Tabela e dytë bazohet në Infrastruktura Ekonomike (sipërfaqet) e cila mbulon gjashtë sektorë tjerë (ekonomik, tregtar, industrial, shërbyes, bujqësor dhe pyjor) si dhe kërkon të dhënat e mëposhtme: sipërfaqja e lokacionit (ha), paraqitja në hartë dhe ndarja sipas vendbanimeve.

| # | Të dhënat komunale | Struktura e PZHK-së | Infrastruktura Ekonomike (Sipërfaqet) |
|---|----------------------------|---------------------|---------------------------------------|
| 1 | Të disponueshme | 73.10% | 9.55% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 13.44% | 9.55% |
| 3 | Jo të disponueshme | 11.76% | 48.74% |
| 4 | Nuk aplikohen | 1.70% | 32.16% |



Diagrami 7.

Disponueshmëria e të dhënave për strukturën dhe infrastrukturën ekonomike (sipërfaqet) të PZHK-së


¹¹ Tabelat e hollësishme të mjeteve për këtë metodologji janë bashkangjitur në Aneks B.

Vendbanimet + Infrastruktura e Banimit (Sipërfaqet/Ndërtesat)

Fusha e dytë tematike përqendrohet në dy tema, pra në dy tabela të populluara gjithashtu. E para ka të bëjë me vendbanimet; ajo mbulon vendbanime zyrtare (urbane/rurale) dhe joformale dhe kërkon të dhëna të tilla si sipërfaqja (ha), popullsia, densiteti dhe afishimi i hartave.

Tabela e dytë ka të bëjë me infrastrukturën e banimit, bazuar në tri kategori të sipërfaqes: tipologjia, funksioni, përdorimi i përzier. Ajo përfshin të dhënat e mëposhtme: sipërfaqen e lokacionit (ha), numrin e njësive të banimit, numrin e ndërtesave, ndarjen sipas vendbanimeve dhe paraqitja në hartë.

| # | Të dhënat komunale | Vendbanimet | Infrastruktura e banimit |
|---|----------------------------|-------------|--------------------------|
| 1 | Të disponueshme | 43.75% | 4.35% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 12.50% | 11.30% |
| 3 | Jo të disponueshme | 6.25% | 84.35% |
| 4 | Nuk aplikohen | 37.50% | |




Diagrami 8. Disponueshmëria e të dhënave për vendbanimet dhe infrastrukturën e banimit

Infrastruktura Publike/Sociale

Ky grup mjetes përqendrohet në sipërfaqet/shërbimet e temave të tilla si: shëndetësia, arsimi, administrimi dhe mbrojtja, mirëqenia sociale dhe komuniteti, feja, kultura/rinia dhe sportet/rekreacioni, dhe hapësirat publike.

Tabelat përmbajnë një sërë të dhënash siç janë: sipërfaqja (ha), zona e ndërtesave kryesore/dytësore (m²), numri i personelit, numri i personave që përdorin shërbime, madhësia e parcelës dhe zona e ndërtimit sipas standardeve, ndarja sipas vendbanimit, paraqitja në hartë, etj.

| # | Të dhënat komunale | Infrastruktura Publike/Sociale |
|---|----------------------------|--------------------------------|
| 1 | Të disponueshme | 11.31% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 1.01% |
| 3 | Jo të disponueshme | 61.56% |
| 4 | Nuk aplikohen | 26.13% |




Diagrami 10. Disponueshmëria e të dhënave për shërbimet dhe infrastrukturën sociale dhe publike

Demografia + Infrastruktura Ekonomike (Ndërmarrja) + Buxheti

Seti tjetër përfshin tri fusha tematike (rrjedhimisht tri tabela të populluara). Tabela e parë tematike ka të bëjë me demografinë, e cila paraqet statistikën komunale bazuar në të dhënat e mëposhtme: popullsia, njësitë e ekonomive familjare, mosha, përkatësia etnike, shkalla e punësimit, arsimi, migracioni dhe rritja e popullsisë për 8 vitet e ardhshme. Fusha e dytë tematike merret me infrastrukturën ekonomike dhe bazohet në dy tema. E para është ndërmarrjet ekonomike/publike dhe punonjësit, të ndara në tri kategori: ndërmarrje private ekonomike, ndërmarrje / institucione publike dhe ndërmarrje ekonomike me pronësi shoqërore (jo të privatizuara). Të dhëna të rëndësishme për t'u identifikuar: numri i ndërmarrjeve/ institucioneve, numri i të punësuarve dhe ndarja sipas vendndodhjes/ vendbanimit. Fusha e tretë tematike trajton kapacitetet financiare në drejtim të shpenzimeve buxhetore dhe të ardhurave deri më tani nga dita e miratimit të PZHK-së, dhe viteve të ardhshme gjithashtu.

| # | Të dhënat komunale | Demografia | Infrastruktura Ekonomike/ Ndërmarrjet | Buxheti |
|---|----------------------------|------------|---------------------------------------|---------|
| 1 | Të disponueshme | 55.17% | 22.22% | 31.43% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 24.14% | 30.56% | 68.57% |
| 3 | Jo të disponueshme | 10.34% | 30.56% | |
| 4 | Nuk aplikohen | 10.34% | 16.67% | |




Diagrami 9. Disponueshmëria e të dhënave për demografinë, infrastrukturën ekonomike (ndërmarrja) dhe buxheti

Infrastruktura Teknike

Shërbimet dhe infrastruktura teknike përqendrohen në aspektet teknike të komunës siç janë furnizimi me ujë, sistemet e ujërave të zeza, energjia elektrike dhe menaxhimi i mbeturinave; të dhënat për këto shërbime sigurohen bazuar në vendbanime, numrin e përdoruesve, gjendjen fizike të sistemit, zonën e ndërtimit (m²), sipërfaqen e parcelës (ha), kapacitetet financiare dhe të infrastrukturës, etj.

| # | Të dhënat komunale | Infrastruktura Teknike |
|---|----------------------------|------------------------|
| 1 | Të disponueshme | 37.36% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 16.48% |
| 3 | Jo të disponueshme | 36.26% |
| 4 | Nuk aplikohen | 9.89% |




Diagrami 11. Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën teknike

Infrastruktura e Transportit Publik

Tabelat e radhës të vlerësimit identifikojnë të dhënat për kategoritë e infrastrukturës së transportit. Rrugët, hekurudhat, automjetet pa motor, infrastruktura e ndërtimit të transportit ose çfarëdo lloj shërbimi tjetër, të gjitha i përkasin kësaj kategorie. Për t'i vlerësuar këtë kategori, janë regjistruar një sërë të dhënash siç janë: vendbanimet e lidhura, lloji, madhësia dhe gjerësia e rrugës, trotualet dhe parkimi, shtigjet, zonat e ndërtesave, etj.

| # | Të dhënat komunale | Infrastruktura e Transportit Publik |
|---|----------------------------|-------------------------------------|
| 1 | Të disponueshme | 6.06% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 7.74% |
| 3 | Jo të disponueshme | 22.56% |
| 4 | Nuk aplikohen | 63.64% |




Diagrami 12. Disponueshmëria e të dhënave për infrastrukturën e transportit publik

Trashëgimia Kulturore/Natyrore + Mjedisi

Këto fusha tematike të fundit përfshijnë dy tabela mjetesh që duhet të popullohen. E para ka të bëjë me trashëgiminë kulturore dhe natyrore me kategori të tilla si trashëgimi arkitektonike, arkeologjike dhe natyrore. Të dhënat e kërkuara për këtë fushë janë vendbanimi, numri i ID-së dhe koordinatat, vendndodhja dhe madhësia e ndërtesës, statusi ligjor, paraqitja në hartë, etj. c

E dyta ka të bëjë me mjedisin, ose ndotjen (katastrofat natyrore/njerëzore dhe rreziqet) më saktë; të dhënat e kërkuara të radhitura në tabelë janë si në vijim: vendbanimi/vendndodhja, hapësirat e ndotura/të kërcënuara, shkaku i ndotjes/rrezikur, paraqitja në hartë, etj.

| # | Të dhënat komunale | Trashëgimia Kulturore dhe Natyrore | Mjedisi |
|---|----------------------------|------------------------------------|---------|
| 1 | Të disponueshme | 6.15% | 62.90% |
| 2 | Pjesërisht të disponueshme | 2.05% | 37.10% |
| 3 | Jo të disponueshme | 25.13% | |
| 4 | Nuk aplikohen | 66.67% | |



Diagrami 13. Disponueshmëria e të dhënave për trashëgiminë kulturore/natyrore dhe mjedisin

3.3.3 Vlerësimi i PZHK-së sipas zbatueshmërisë

Pjesëmarrësit u ndanë në 6 grupe për të përfunduar këtë detyrë të fundit bazuar në objektivat e PZHK, këtë herë duke përdorur tabelën e investimeve kapitale për të identifikuar aktivitetet dhe shërbimet e zbatuara nga dita e miratimit të PZHK deri më tani. Secila tabelë në këtë metodologji përfshin një fushë ndërdisciplinore tematike në detaje duke siguruar kështu informata shtesë për objektivat dhe aktivitetet me elementet si në vijim: partnerët e financimit, fazën e zbatimit, përparësitë, koston dhe treguesit. Elementet e përmendura, të domosdoshme për të realizuar këtë metodologji, u hulumtuan dhe u mbledhën në formën e të dhënave para kësaj punëtorie. Tabela 11 tregon një skemë të thjeshtuar të tabelave të mjeteve të zbatimit, duke shfaqur fushat tematike, objektivat dhe numrin e aktiviteteve për secilën objektive.

FUSHAT TEMATIKE

| Zhvillimi Social | Zhvillimi Ekonomik | Infrastruktura e Transportit Publik | Infrastr. Teknike | Shfrytëzimi i tokës, vendbanimet dhe banimi | Mjedisi, Trashëgimia, Vlerësimi i rrezikut dhe Menaxhimi i fatkeqësive |
|------------------|--------------------|-------------------------------------|-------------------|---|--|
|------------------|--------------------|-------------------------------------|-------------------|---|--|

OBJEKTIVAT

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|--|----------------------|---|--|---|---|---|--|---|---|--|--|--|---|--|---|---|--|---|--|---|---|--|--|
| Mundësi të reja të ornuara për biznesin e fokusuar | Kryesisht në bujqësi | Inkurajimi i grave që të vazhdojnë me arsim të lartë dhe për t'u angazhuar në aktivitete publike dhe të punësohen | Avancimi i infrastrukturës sociale si dhe i shërbimeve arsimore dhe shëndetësore përmes zhvillimit të vazhdueshëm të kapaciteteve të stafit në këto shërbime | Promovimi dhe zhvillimi i revitalizimit të trashëgimisë kulturore | Permitësimi i objekteve sportive dhe rekreative sipas standardeve moderne | Avancimi dhe promovimi i produkteve bujqësore dhe blegtorale nëpërmjet sigurimit të qasjes në tregjet lokale dhe rajonale | Promovimi i raufjes dhe zhvillimit të mëtejshëm të bizneseve të vogla dhe të mesme | Krijimi i kushteve për fermerët që të kenë qasje në kredi dhe subvencione | Permitësimi i infrastrukturës rrugore në të gjithë territorin e komunës dhe sigurimi i saj sipas kërkesës së fermerëve për zonat bujqësore për fermerët e parashikuar | Inkurajimi i përdorimit të mënyrave jo të motorizuara të transportit dhe sigurimi i transportit të sigurt publik | Qasja në shërbimet publike (ujë, kanalizim, rrymë, telekomunikacion) të parashikuara | Promovimi i menaxhimit dhe trajtimit të mbetjeve të ngurta, mbeturinave dhe ujërave të zeza përmes aktiviteteve adekuate | Ortimit i instrumenteve të planifikimit për mbrojtjen dhe kontrollin e zhvillimeve në komunë janë ornuar dhe ndërgjegjësimi të qytetarëve për procesin e planifikimit dhe të përfitmeve të kontrollit të zhvillimit | Rritja e cilësisë së zonave të banimit nëpërmjet hapësirave publike cilësore dhe shërbimet e nevojshme sociale dhe programet | Plotësimi i zbratirave (brenda parcelave) dhe dendësimiti brenda kufijve të vendbanimit inkurajohen | Rritja e kapaciteteve të stafit komunal në administratën publike dhe planifikim | Themelimi i bazës së të dhënave në GIS | Lehtësimi i procedurave mbi administratën publike | Reduktimi i ndotjes së tokës dhe lumit me mbeturina të ngurta, pesticide dhe ujëra të zeza | Ngritja e vetëdijes mbi legjislacionin mjedisor | Mbrojtja e burimeve natyrore duke përfshirë biodiversitetin nga degradimi | Zvogëlimi i ndikimit negativ në mjedis, në fusha të prirura për fatkeqësi natyrore | Organizimi i aktiviteteve për reduktimin e efekteve të ndryshimeve klimatike |
|--|----------------------|---|--|---|---|---|--|---|---|--|--|--|---|--|---|---|--|---|--|---|---|--|--|

NR. I AKTIVITETEVE PËR ÇDO OBJEKTIVË *


| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|----|---|---|---|---|---|---|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 4 | 3 | 8 | 15 | 1 | 1 | 2 | 7 | 1 | 4 | 12 | 5 | 2 | 3 | 2 | 2 | 3 | 4 | 4 | 4 | 3 | 2 | 5 | 2 |
|---|---|---|----|---|---|---|---|---|---|----|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|

Table 10. Objektivat për secilën fushë tematike dhe numri i aktiviteteve

Zhvillimi Social

Objektivi kryesor në këtë fushë është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në të gjithë sektorët, veçanërisht në bujqësi dhe blegtori.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 4 | 0.00 | 100.00 | 0.00 |
| 2 | 3 | 0.00 | 100.00 | 0.00 |
| 3 | 8 | 25.00 | 62.50 | 12.50 |
| 4 | 3 | 66.67 | 33.33 | 0.00 |
| 5 | 2 | 50.00 | 50.00 | 0.00 |




Diagrami 14. Zbatimi i objektivave të zhvillimit social

Infrastruktura Teknike

Qëllimi kryesor në këtë pjesë është përmirësimi i shërbimeve publike sipas standardeve moderne evropiane. Ai përqendrohet në qasjen në shërbimet themelore publike dhe shërbimet komunale siç janë furnizimi me ujë, sistemet e kanalizimit, energjia elektrike, telekomunikacioni, menaxhimi i mbeturinave etj.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 12 | 0 | 16.67 | 83.33 |
| 2 | 5 | 0 | 60.00 | 40.00 |




Diagrami 17. Zbatimi i objektivave të infrastrukturës teknike

Zhvillimi Ekonomik

Objektivi kryesor në këtë fushë është zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik në të gjithë sektorët, veçanërisht në bujqësi dhe blegtori.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 15 | 0 | 66.67 | 33.33 |
| 2 | 1 | 0 | 100.00 | 0.00 |
| 3 | 2 | 0 | 100.00 | 0.00 |




Diagrami 15. Zbatimi i objektivave të zhvillimit ekonomik

Përdorimi i tokës, Vendbanimet dhe Vanimi

Ky segment është një nga më të rëndësishmit pasi përshkruan se si dhe për çfarë përdoret toka komunale. Qëllimet kryesore të parashikuara renditen si vijon: (1) mbrojtja dhe përdorimi racional i tokës përmes mekanizmave ligjorë dhe (2) përmirësimi i administratës publike në nivelin lokal.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 2 | 50.00 | 50.00 | 0.00 |
| 2 | 3 | 33.33 | 66.67 | 0.00 |
| 3 | 2 | 50.00 | 50.00 | 0.00 |
| 4 | 2 | 0.00 | 0.00 | 100.00 |
| 5 | 2 | 0.00 | 50.00 | 50.00 |
| 6 | 3 | 0.00 | 33.33 | 66.67 |
| 7 | 4 | 50.00 | 50.00 | 0.00 |




Diagrami 18. Zbatimi i objektivave të përdorimit të tokës, vendbanimeve dhe banimit

Infrastruktura e Transportit Publik

Kjo tabelë trajton infrastrukturën rrugore, transportin dhe shërbimet publike. Objektivat kryesore si në vijim janë parashikuar për zhvillimin e ardhshëm: (1) përmirësimi, zgjerimi dhe ndërtimi i infrastrukturës fizike në bazat komunale sipas standardeve moderne, dhe (2) sigurimi i sistemeve efikase të transportit për njerëzit dhe mallrat.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 7 | 100 | 0 | 0 |
| 2 | 1 | 100 | 0 | 0 |
| 3 | 4 | 25 | 50 | 25 |




Diagrami 16. Zbatimi i objektivave të infrastrukturës së transportit publik

Trashëgimia Kulturore/Natyrore dhe Mjedisit

Qëllimet kryesore të kësaj fushe tematike janë: (1) mbrojtja dhe zhvillimi i qëndrueshëm i mjedisit dhe (2) zvogëlimi i rrezikut dhe administrimi i ndikimit negativ mjedisor të shkaktuar nga katastrofat natyrore ose aktivitetet e nxitura nga njeriu.

| Objektivat | Aktivitetet | Të zbatuara | Të pazbatuara | Pjesërisht të zbatuara |
|------------|-------------|-------------|---------------|------------------------|
| 1 | 4 | 25.00 | 25 | 50.00 |
| 2 | 3 | 33.33 | 0 | 66.67 |
| 3 | 2 | 0.00 | 50 | 50.00 |
| 4 | 5 | 20.00 | 60 | 20.00 |
| 5 | 2 | 0.00 | 50 | 50.00 |



Diagrami 19. Zbatimi i objektivave të trashëgimisë kulturore/natyrore dhe mjedisit



KAPITULLI I KATËRT


4.1 Të gjeturat

Ky raport vlerësimi adreson një numër elementesh në lidhje me PZHK-në e Mamushës, siç janë kërkesat ligjore, zbatimi i objektivave dhe vlerësimi i qëndrueshmërisë. Vlerësimi është bërë përmes mjeteve tabelare që ndihmuan në identifikimin e të dhënave të nevojshme. Të gjeturat kryesore janë nxjerrë duke pasur parasysh situatën aktuale të zhvillimit komunal dhe bazuar në qëllimet e përcaktuara në PZHK dhe pajtueshmërinë e ligjit gjithashtu.

I. Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

Rezultatet e ushtrimit të qëndrueshmërisë zbuluan domosdoshmërinë për një koordinim më të mirë vertikal dhe horizontal midis të dy niveleve të qeverisjes (qendrore/lokale) dhe palëve të tjera të interesit (përfshirë qytetarët) gjatë hartimit të dokumenteve të planifikimit, përkatësisht gjatë ndërmarrjes së reformës ligjore.

Fakti që ekziston një mospërputhje e konsiderueshme midis rezultateve të temave/fushave të ndryshme të vlerësuara (pikët maksimale: planifikimi urban dhe i tokës, pikët minimale: kodi i ndërtimit) si në aspektet e efektivitetit funksional ashtu edhe në ato teknike, do të thotë që për të pasur zhvillim të qëndrueshëm, legjislacioni në fuqi duhet të plotësohet me personel të përshtatshëm, mjete financiare, mekanizma të planifikimit/koordinimit dhe sistem të monitorimit/vlerësimit/raportimit.




Diagrami 20. Rezultatet e krahasimit për të gjitha fushat tematike - Korniza e Vlerësimit të Qëndrueshmërisë

II. Vlerësimi i PZHK bazuar në kërkesat ligjore (të dhëna të nevojshme për HZK)

Nga Diagrami 7 dhe Shtojca B (tabela 1, f. 54-55) është e qartë se Struktura e Planit aktual Zhvillimor Komunal (PZHK) është relativisht mirë në përputhje me legjislacionin në fuqi të planifikimit hapësinor. Kapitulli i profilit është mjaft i mbuluar në analizën/ informacionin sektorial dhe të përgjithshëm, duke përjashtuar pjesën e banimit që mungon dhe pjesën e pyjeve dhe të trashëgimisë që nuk u trajtuan për shkak të pranisë shumë të kufizuar të tyre në Mamushë. Kapitulli i planifikimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme që do të përdoren për zhvillimin e planeve territoriale dhe sektoriale (vizioni, qëllimet dhe objektivat; koncepti i zhvillimit hapësinor dhe planet e zhvillimit sektorial; dhe plani i veprimit). Pjesa grafike plotëson në tërësi informacionin e mësipërm me praninë e rëndësishme të hartës së shfrytëzimit të tokës dhe hartave tjera sektoriale të nevojshme, duke përjashtuar transportin dhe menaxhimin e mbeturinave që mungojnë. Sidoqoftë, kjo mund të zhvillohet lehtësisht duke marrë parasysh sipërfaqen e vogël të Komunes.

